



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË

Adresa: Blv. "Fan Stijan Noli" Korçë

Tel +355 (0) 243366

K Ë R K E S Ë

"Për caktimin e masës së sigurimit"

**PARA :
GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË**

Në Korçë, më datë 21.01.2016, unë Dhorina Theodhori, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi studiova aktet e proçedimit penal nr. 68, viti 2016.

KONSTATOVA :

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë janë dërguar materialet hetimore me shkresën me nr. 147 prot, datë 20.01.2016 nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, për veprën penale të "Pastrimi I produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal.

Nga aktet e administruara në dosjen hetimore rezulton se nga ana e strukturave policore te Sektorit per Krimin Ekonomik e Financar ne Drejtorine Vendore te Policise Korce, jane administruar te dhena, per shtetasen **Erika H. S.**, e datëlindjes 07.09.1987, banuese ne fshatin Voskop-Korçë, e cila më datë 21.12.2015 ka depozituar pranë Raiffeisen Bank shumën 15 000 Euro, duke deklaruar se është e papunë dhe fondet janë "kursime familjare".

Në vijim të kryerjes së veprimeve verifikuese ka rezultuar se :

Më datë 18.01.2016, shtetasja **Erika S.** ka kërkuar të kryejë një transfertë në vlerën prej 14.000 euro në favor të shtetasit nga Libani, **Ramir I.** në Beirut, Liban. Ajo ka deklaruar se: "**Ramir I.** është me profesion ushtarak dhe se është i dashuri i saj, të cilin e ka njohur

Kërkesa për caktimit të masës së sigurimit pasuror lidhur me proçedimin penal nr. 68, 1
viti 2016.

nëpërmjet rrjeteve sociale "facebook". Qëllimi i dërgimit të fondeve sipas saj është për "arsye shëndetësore" e njëkohësisht ka dërguar nëpërmjet e mailit të saj edhe dokumentin e identifikimit të shtetasit Libanez me detaje (foto). Nga verifikimi në lidhje me shtetasen **Eutela Sh.** dhe familjarët e saj, shtetasit **H.** **H.** **S.**, i dtl 27.11.1950, shtetasit **N.** **S.** **S.** e datëlindjes 03.01.1955 dhe **A.** **H.** **S.** i datëlindjes 14.06.1981, ka rezultuar se ka transaksione të vlerave vetëm në emër të vëllait të saj, shtetasit **A.** **S.**, si vijon:

- Më datë 04.01.2013, ka kryer depozitime cash pranë Alpha Bank në vlerat 14 000 Euro dhe 10 000 Euro.
- Më datë 22.01.2013, ka tërhequr nga llogaria pranë Alpha Bank shumën 8 000 Euro.
- Në datat 30.04.2013 dhe 12.09.2013, ka tërhequr nga llogaria pranë Alpha Bank përkatësisht shumat 1 700 000 Lekë dhe 11 900 Euro.

Nga verifikimet e kryera në kartoteken e policisë kriminale të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, ka rezultuar se shtetasi **A.** **S.**, i dtl. 14.06.1981, në dt. 18.03.2014, është regjistruar si person me precedent kriminalë për veprën penale të trafikimit të narkotikeve. Sipas informacioneve të mara për shtetasin **A.** **S.**, ka rezultuar se ky shtetas në dt. 10.12.2013, është arrestuar në shtetin Grek, me lende narkotike.

Nga verifikimi për biznes të regjistruara (QKR) në emër të shtetasve të mësipërm rezulton se shtetasit **H.** **S.** është ortak themelues në shoqërinë "Shaholli Energy" shpk me NIPT K74102014I, themeluar në Korçë më datë 02.05.2007 e me objekt të veprimtarisë "Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha mallrave industriale, ekonomike, bujqësore, metale, duralumin. Projektim, ndërtim dhe shfrytëzim të hidrocentraleve dhe të termoçentrale..." Ky subjekt ka depozituar në QKR vetëm vendimin e rregjistrimit në vitin 2007 dhe bilacin e vitit 2007 dhe nuk ka asnjë depozitim dokumentacioni tjetër.

Nga verifikimi në sistemin e hyrje daljeve (TIMS) rezulton se shtetasi **R.** **E.** nuk ka hyrë asnjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërsa shtetasja **E.** **S.** rezulton të ketë tre hyrje dalje brenda

Nga sa më sipër, duke marrë në konsideratë destinacionin e transfertës, lidhjen e paqartë midis përfituesit dhe dërguesit (arsyetimi me njohje në facebook), pra dërgimi tek një i panjohur që nuk e ka takuar asnjëherë i shumës 14 000 Euro ekzistojnë dyshime mbi përdorimin e tyre edhe pse burimi mund të jetë nga familjarët.

Sipas informacionit të siguruar rezulton se është vendosur bllokimin i përkohshëm i llogarisë bankare Nr.803346 në Euro pranë Raiffesien Bank të shtetasës **E.** **S.**

Në përgjigje të kërkesës së organit procedues, Raiffesien Bank, me shkresën me nr. 6211 prot, datë 21.01.2016 ka saktësuar faktin se shtetasja **E.** **S.** është kliente e kësaj banke dhe ka llogaritë e mëposhtme :

- Nr : 7000803346 në lekë.
- Nr. 0010803346 në euro.

Për të gjitha arsyet e parashtruara me sipër, për të garantuar ecurinë e mëtejshme të hetimeve, prokuroria vlerëson se vendosjen e masës së sigurimit pasuror e sekuestros preventive mbi llogarinë bankare të shtetasit ~~E. Sh.~~ në llogarinë e saj në Bankën Raiffeisen është e domosdoshme pasi disponimi I lirë I llogarisë bankare të poseduar prej kësaj shtetase mund të vijojë zgjatjen e pasojave të veprën penale për të cilën është rregjistruar ky procedim penal.


Për sa më sipër, duke pasur parasysh rrethanat e ngjarjes, kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 274, 275, 276 të K.Pr.Penale

K Ë R K O J :

1. Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të "sekuestro preventive" të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, ndaj llogarisë bankare të shtetases ~~E. Sh.~~ (në lekë dhe në euro) pranë Raiffeisen Bank.

Kërkesës i bashkohen edhe shkresa dhe dokumenta që i përkasin procedimit penal nr.68 të vitit 2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

PROKURORE E ÇËSHTJES
Dhorina THEODHORI



Shënim: Çështja është pezulluar. Sekuestroja
përmbluar në gjyq aktualisht.

Konceluar

S. Stafabëndler

